

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented  
by the Council of Europe

## Raport

### Tryezë e rumbullakët rajonale *online* “Videokonferencat në procedimet gjyqësore: standardet e të drejtave të njeriut”



korrik 2020

© 2020 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Licencuar për Bashkimin Evropian sipas kushteve të caktuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet apo të transmetohet, në asnjë formë dhe përmes asnjë mënyrë, elektronike (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanike, duke përfshirë edhe fotokopjimin, regjistrimin dhe çdo sistem për ruajtje apo gjetje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimeve (F-67075 Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dh Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim zyrtar i asnjërës palë.



## Pasqyra e lëndës

### I. Përmbledhje: Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe përvoja e vendeve të ndryshme 5

1. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ..... 5
2. Përvojat e vendeve/përmbledhje ..... 5

### II. Garancitë procedurale 6

3. Pjesëmarrja në distancë e dëshmitarëve dhe e viktimave dhe vlerësimi i dëshmive ..... 6
4. Prezantimi i provave gjatë seancave në distancë dhe shkëmbimi i dokumenteve shkresore ..... 6
5. Natyra publike e seancave dhe aksesit i publikut dhe medias ..... 7
6. Përkthimi ..... 7

### III. Komunikimi me avokatin 8

7. Komunikimi privat me avokatin gjatë seancave online ..... 8
8. A mund t'i hiqet zëri apo figura një avokati dhe/ose një pale gjatë një videokonference nga gjyqtari? Cilat JANË rregullat procedurale? ..... 8
9. Si duhet të veprojnë një gjyqtar në rastin e një lidhjeje jo të mirë të internetit dhe pamundësisë së një pale për të dëgjuar/për të folur? ..... 9
10. A ka rregullore të posaçme procedurale për seancat në distancë dhe çfarë duhet marrë parasysh në këto raste? ..... 9

### IV. Videokonferenca për vendimet e masave të sigurisë 10

11. A mund të merren masat e sigurisë përmes videokonferencave? Cilat janë specifikat e procedurave në këto raste? ..... 10

Tryeza Rajonale e Rrumbullakët *online* “Videokonferencë për procedurat gjyqësore: standardet e të drejtave të njeriut” u fokusua në aspekte të ndryshme të së drejtës për gjykim të drejtë, mishëruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) në kohën e pandemisë së Covid-19, veçanërisht në mënyrën e sigurimit të garancive procedurale në procedimet gjyqësore gjatë krizave të jashtëzakonshme sanitare.

Efikasiteti i pjesëmarrjes së secilës palë në gjykim varet nga mundësia e tyre për t’u shprehur qartë dhe për të përfaqësuar interesat e tyre. Ky parim është i pandashëm nga e drejta e garantuar nga neni 6 i KEDNj-së si në procedimet civile dhe penale, ashtu edhe në ato administrative. Pandemia e Covid-19 shfaqi sfida të paprecedentë për shumë të drejta të njeriut, duke përfshirë edhe fushën e drejtësisë, ku filloi të krijohet një realitet i ri: gjykimet duhet të vazhdonin edhe në kushtet e rregullave të distancimit fizik dhe kufizimet e udhëtimeve nuk u lejuan palëve gjithmonë mundësinë për të qenë të pranishme në gjykim. Në të njëjtën kohë, përdorimi i zgjidhjeve IT nuk mund të zëvendësonte domosdoshmërisht praninë fizike në mungesë të rregullave të qarta dhe qasjeve të konsoliduara nga gjykatat. Ekzistenca e zgjidhjeve të besueshme kompjuterike që do të lejonte lidhje të sigurta dhe të qëndrueshme u kthye në një tjetër problem. Krejt papritur, aspekte të shumta mund të çonin në probleme sa i përket respektimit të KEDNj-së: akustika jo e mirë në sallat e gjykimet, lidhja jo e mirë me internetin, shqetësimet për të dhënat personale, mundësia për përkthim, aksesit i publikut në seancat gjyqësore, etj.

Komisioni Evropian (CEPEJ) publikoi një [Deklaratë për “Mësimet e nxjerra dhe sfidat me të cilat u përball gjyqësori gjatë pandemisë së COVID-19 dhe pas saj”](#), ku theksoheshin përpjekjet e konsiderueshme të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës për t’u përshtatur rrethanave të reja brenda një kohe të shkurtër dhe për të shfrytëzuar sa më mirë burimet ekzistuese për garantimin e funksionimit të gjykatave të tyre. E megjithatë, një krizë e tillë shëndetësore mund të përsëritet. Sistemet gjyqësore duhet të përgatiten, sidomos sa u përket zgjidhjeve efikase për të garantuar vazhdimësinë e punës së gjykatës dhe aksesin në drejtësi, duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat individuale.

Në botimin e tij me titull [“Gjykimet dhe proceset gjyqësore në distancë në përgjigje të COVID-19 në misionet dhe kontekste të tjera të ndjeshme”](#), Shërbimi i Kombeve të Bashkuara për Korrigjimet dhe Drejtësinë theksoi përdorimin e mundësive për videokonferencë dhe përdorimin e teknologjive të tjera për zhvillimin e seancave gjyqësore dhe proceseve të tjera gjyqësore në distancë, të cilat do të përdoren jo vetëm për zbutjen e risqeve të COVID-19, por do të merren gjithashtu parasysh edhe në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë si masë që mund të ndihmojë në përmirësimin e aksesit në drejtësi në kushtet kur mungesa e sigurisë, kufizimi i transportit, pengesat logjistike dhe pengesa të tjera mund të pengojnë ofrimin e shërbimeve të drejtësisë.

Kjo Tryezë e Rrumbullakët pati për qëllim diskutimin e aspekteve të të drejtave të njeriut në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore *online* nga gjykatat në vendet e tyre përkatëse, si dhe adresimin e disa çështjeve praktike në lidhje me këto organizime dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e Konventës.

Diskutimi u fokusua kryesisht tek masat e marra për mundësimin e organizimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore në kushtet e izolimit. Megjithatë, kjo përvojë e re do të jetë e rëndësishme edhe pas krizës së COVID-19 dhe ajo përbën një mundësi të mirë për ndryshime dhe përmirësime afatgjata në funksionimin e gjykatave kombëtare.

## I. Përmbledhje: Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe përvoja e vendeve të ndryshme

### 1. JURISPRUDENCA E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Teknologjitë IT dhe videokonferencat janë përdorur nga vende të ndryshme tashmë prej disa kohësh me premtimin se do të sillnin efikasitet dhe më shumë akses në drejtësi. Megjithatë, mbeten ende shumë sfida për t'u përballuar. Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), nuk ka shumë raste të tilla, por standardet e vendosura të Konventës vlejné edhe për gjykimet në distancë. Sipas vendimit të Dhomës së Madhe në çështjen *Sakhnovskiy*<sup>ii</sup>, përdorimi i videokonferencave nuk përbën problem, por as avantazh sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Videokonferencat janë thjesht një teknologji që mund të përdoret në procedimet e gjykatës. Përdorimi i teknologjive të tilla nuk i çliron autoritetet kombëtare nga detyrimet e tyre sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Qëllimi kryesor i nenit 6 është të garantojë drejtësinë e përgjithshme të procedimeve, të cilat vlerësohen duke pasur parasysh rrethanat e posaçme të secilës çështje. Përdorimi i videokonferencave dhe aspekteve praktike që lidhen me to përcaktohet nga gjyqtari. Është gjyqtari ai që është në gjendje të sigurojë një proces të drejtë dhe të marrë parasysh të gjitha implikimet e mundshme që mund të rrjedhin nga përdorimi i zgjidhjeve teknologjike në çështjen në fjalë. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar mirë dhe të garantojë një ekuilibër të drejtë mes të drejtave të palëve të përfshira në procedim.

### 2. PËRVOJAT E VENDEVE/PËRMBLEDHJE

Ekspertët nga Serbia, Rusia, Franca dhe Anglia ndanë përvojat e vendeve të tyre sa i përket përdorimit të videokonferencave në seancat gjyqësore, sidomos gjatë krizës së Covid-19. Në pjesën më të madhe të vendeve të marra si referencë, disa gjyqe ishin shtyrë gjatë periudhës së kësaj krize, kurse në disa vende të tjera, çështjet ishin ndarë në kategori sipas urgjencës dhe ishin mbajtur ose *online* ose në sallën e gjyqit (duke respektuar masat parandaluese sanitare). Franca dhe Anglia i kanë përdorur gjerësisht videokonferencat që përpara izolimit të Covid-19, kurse Rusia dhe Serbia filluan t'i përdorin ato më shumë gjatë kësaj krize. Në Rusi, videokonferencat përdoren më shumë nga gjykatat tregtare. Gjithashtu, në këtë vend ka filluar të përdoret një tjetër lloj gjykimi në distancë – një gjykim “hibrid”, ku gjyqtarët qëndrojnë në sallën e gjyqit, ndërsa palët marrin pjesë në këto seanca në distancë. Përdorimi i procedimeve hibride do të vazhdojë me shumë gjasë edhe pas pandemisë për arsye praktike: këto lloj gjykimesh i shërbejnë drejtësisë në vende të mëdha, ku distancat mes rajoneve të ndryshme, si në Rusi, janë shumë të mëdha.

Ndonëse është në dorën e gjyqtarit të përcaktojë modalitetet e organizimit të seancave gjyqësore, në Francë ka debate mbi atë se kush (gjyqtarët apo palët) duhet të jetë përgjegjës për të vendosur nëse një seancë e caktuar gjyqësore duhet të zhvillohet *online* apo në formën e zakonshme. Në Angli, janë vënë re disa vështirësi praktike sa u përket gjykimeve me juri, të cilat janë shtyrë për arsye sigurie gjatë periudhës së izolimit. Një eksperiment i zhvilluar nga një OJQ angleze tregoi se videokonferencat janë të përshtatshme për çështje të shkurtra dhe të thjeshta, ndërkohë që nuk mund të jenë gjithmonë të përshtatshme për çështje komplekse. Në të gjitha rastet, ajo çka mbetet çështje e rëndësishme dhe që duhet të merret parasysh është drejtësia e procedimeve dhe interesi i drejtësisë.

## II. Garancitë procedurale

### 3. Pjesëmarrja në distancë e dëshmitarëve dhe e viktimave dhe vlerësimi i dëshmive

Sa i përket pjesëmarrjes në distancë, çështja shumë e rëndësishme që mbetet ende e pazgjidhur është siguria e informacionit dhe identifikimi i palëve. Cilësia teknike e videokonferencave përbën një parakusht për pjesëmarrjen efikase të dëshmitarëve. P.sh., gjykatat tregtare ruse kanë platformat e tyre me sistemet e informacionit që u lejojnë identifikimin e palëve në gjykim. Megjithatë, duke qenë se ky sistem nuk është i disponueshëm për gjykatat e përgjithshme, disa çështje urgjente u gjykuan në platforma të hapura komunikimi, si në Skype ose në Whatsapp. Edhe gjykatat serbe përdorën Skype-in dhe çështja e nivelit të sigurisë së kësaj platforme komunikimi për seanca gjyqësore mbetet ende e hapur. Legjislacioni serb parashikon mundësinë e pjesëmarrjes së dëshmitarëve në distancë, sidomos për dëshmitarët vulnerabël. Kështu, pjesëmarrja në distancë mund të jetë një zgjidhje e mirë kur dëshmitari nuk mund të jetë i pranishëm fizikisht.

Në Angli u hartuan udhëzime të përshtatshme për të ndihmuar dëshmitarët në pjesëmarrjen e tyre në gjykimet *online*. Sjellja në procedimet përmes videove duhet të jetë e njëjtë me atë në sallën e gjyqit. Megjithatë, disa OJQ ngritën pikëpyetje mbi pamundësinë për të marrë pjesë në mënyrë efikase të dëshmitarëve me aftësi të kufizuara (sidomos të atyre me aftësi të kufizuara në komunikim). Ndryshe nga këto kategori, pjesëmarrja në distancë për disa kategori dëshmitarësh mund të ishte avantazhuese (p.sh., për të miturit ose për viktimat e krimeve seksuale). Pyetjet mbi metodat ekzistuese për të siguruar autenticitetin e dëshmive të dëshmitarëve gjatë *cross examination* nuk duket të ketë zgjidhje për momentin dhe mund të rregullohet me përdorimin e zgjidhjeve të posaçme teknike. Në përgjithësi, mundësia e pjesëmarrjes së dëshmitarëve, efikasiteti i përgjithshëm i drejtësisë dhe drejtësia e procedimeve vazhdojnë të mbeten aspekte shumë të rëndësishme në marrjen e vendimit nga gjyqtari për të përdorur apo jo videokonferencat.

### 4. Prezantimi i provave gjatë seancave në distancë dhe shkëmbimi i dokumenteve shkresore

Në Angli, aksesit dhe shkëmbimi elektronik i dokumentacionit përbën një praktikë normale prej disa vitesh që në fazat e hershme të procedimeve, sidomos në çështjet penale. Aty ka edhe një përdorim të madh të komunikimeve me email mes palëve dhe gjykatës. Përvoja e Rusisë gjatë krizës çoi në rritjen e komunikimit *online* me gjykatat për shkak të nevojës për ndërveprim dhe bashkëpunim mes palëve dhe gjyqtarëve. Prezantimi i dëshmive në Rusi në procedimet *online* lehtësohet normalisht përmes ngarkimit të të gjitha dokumenteve në një sistem IT para gjykimit. Megjithatë, duke qenë se rregullat për bërjen publike të informacioneve nuk janë strikte, palët ndonjëherë nuk i përmbushin këto rregulla dhe paraqesin dokumente të reja përmes ndarjes së ekranit (*screen sharing*) gjatë videokonferencave. Kjo mund të rrezikojë reagimin eficient të palës tjetër sa u përket provave të reja të paraqitura gjatë seancës. Në raste të tilla, pala që reagon ndaj një dokumenti të sapoparaqitur ose e bën këtë *online* ose kërkon pushim gjatë seancës. Çështje të tilla nuk ndodhin në Angli, pasi palët janë të detyruara që ta paraqesin vijën e tyre të mbrojtjes në procedimet para gjykimit dhe mospërmbushja e këtij kushti çon në pamundësinë e tyre për t'u mbështetur në atë lloj mbrojtjeje gjatë gjykimit.

## 5. NATYRA PUBLIKE E SEANCAVE DHE AKSESI I PUBLIKUT DHE MEDIAS

Disa aspekte të rëndësishme të natyrës publike të seancave përfshijnë, pikë së pari, nevojën për mbrojtjen e palëve ndërgjyqëse nga administrata e drejtësisë, duke ruajtur konfidencialitetin, duke mos i bërë informacionet objekt të mbikëqyrjes së publikut dhe, së dyti, nevojën për ruajtjen e besimit tek gjykata. Seancat e mbajtura përmes Skype-it nuk kanë qenë të aksesueshme për publikun e gjerë dhe mund të diskutohet nëse ato kanë qenë apo jo në përputhje me një nga kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së. Nga ana tjetër, transmetimi i seancave të mbajtura në këtë mënyrë mund t'i bënte gjykatat të hapura dhe më të aksesueshme, pavarësisht distancave. Megjithatë, kjo mund të ndodhë vetëm në rast se informacionet gjatë seancave online janë të disponueshme për publikun. Për kapërcimin e pengesave që dalin nga zhvillimi i gjykimeve jashtë sallave të gjyqit, shtetet kanë detyrimin të marrin masa kompensuese për të garantuar informimin si duhet të publikut dhe të medias për vendin se ku do të zhvillohen seancat dhe për t'u dhënë atyre akses efikas<sup>iii</sup>.

Dy janë mundësitë për t'i dhënë akses publikut në gjykim: në kohë reale ose përmes regjistrimeve. Në rastin e parë, privatësia e pjesëmarrësve në gjykim dhe rreziqet ndaj privatësisë së tyre janë faktorë që duhet të merren në konsideratë. Në Angli, të gjitha gjykimet e Gjykatës së Lartë vihen në dispozicion të publikut. Megjithatë, akses i publikut në kohë reale në gjykimet *online* mund të çojë në probleme të tilla si në mbingarkim të Zoom-it, ndërprerje nga publiku, regjistrime të pasakta dhe shkelje të privatësisë.

Në përgjithësi, regjistrimi i të gjitha gjykimeve (siç bëhet në disa juridiksione) mund të kursejë burime sa u përket regjistrimeve të gjykimeve në letër dhe mund të eliminojë disa probleme sa i takojnë besueshmërisë dhe rreziqeve të kundërshtimit të tyre nga palët në gjykim.

Për hir të garancive të gjykimin të drejtë, është gjithashtu e rëndësishme të merren masat e duhura për regjistrimin në video të seancave: të merren masa që në video të shihet e gjithë salla e gjykimin dhe jo vetëm fytyrat e atyre që flasin në një moment të caktuar.

## 6. PËRKTHIMI

Serbia ka një përvojë modeste me përkthimin në distancë në rastet e azilit (përmes telefonit dhe internetit). Përdorimi i përkthimit *online*, sidomos kur bëhet fjalë për gjuhë të rralla) ka mundësuar angazhimin e përkthyesve lokalë, duke përsheptuar procedurat dhe duke ulur kostot (pasi nuk ka qenë e nevojshme që përkthyesit të udhëtojnë). Nga ana tjetër, problemet teknike mund të ndikojnë tek përkthimi dhe tek dinamika e seancave. Gjithashtu, në rastin e përdorimit të platformave të komunikimit jo të besueshme, paraqitja e provave delikate mund të përbëjë problem. Përkthimi në seanca me një numër të madh pjesëmarrësish nuk shkon gjithmonë mirë.

Përvoja franceze, e cila bazohet tek çështjet e azilit dhe lirimimit me kusht, tregon se seancat që zhvillohen në disa gjuhë njëherësh me përdorimin e përkthyesve mund të jenë jashtëzakonisht komplekse. Prej tyre janë nxjerrë këto mësim: (1) përkthyesi duhet të jetë fizikisht afër me personin që nuk flet gjuhën e gjykatës, (2) përkthyesi duhet të jetë i dukshëm në ekran së bashku me palët për të cilat ai/ajo përkthen, dhe (3) gjykata duhet të trajtojë në mënyrë të veçantë vendndodhjen e përkthyesit, kur nuk përdoren video (si dhe përgjithësisht për «ekologjinë audio-vizuale» të sallës së gjyqit).

Në përgjithësi, në përdorimin e videokonferencave, gjyqtarët duhet të marrin parasysh logjistikën dhe masat shtesë që nevojitet të merren për seancat në distancë.



Sidoqoftë, diskrecioni gjyqësor luan rol të rëndësishëm në marrjen e vendimit nëse një çështje specifike është apo jo e përshtatshme për t'u zhvilluar përmes videokonferencave, duke marrë parasysh interesin e drejtësisë, drejtësinë e përgjithshme të procedimeve, efikasitetin e kësaj metode në çdo çështje specifike, si dhe aspektet e veçanta, si përkthimi, pjesëmarrja e dëshmitarëve, zgjidhjet e mundshme teknike dhe besueshmëria e tyre, etj.

### III. Komunikimi me avokatin

#### 7. KOMUNIKIMI PRIVAT ME AVOKATIN GJATË SEANCAVE ONLINE

Komunikimi midis klientit dhe avokatit në mënyrë private gjatë procedimeve penale është një prej garancive që parashikon neni 6. E drejta për ndihmë ligjore efikase përfshin, mes të tjerash, të drejtën e të akuzuarit për të komunikuar me avokatin e tij privatisht. Nëse një avokat nuk mund të komunikojë me klientin e tij dhe nuk mund të marrë udhëzime konfidenciale prej tij pa u mbikëqyrur, ndihma që ai jep mund të humbasë një pjesë të mirë të dobishmërisë së saj<sup>iv</sup>.

Gjatë seancave *online* duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë masave përkatëse (duke përfshirë edhe masa teknike) me qëllim shmangien e çdo rasti presioni apo ndikimi tek personi i akuzuar (sidomos personi i ndaluar), gjë që mund të mos jetë e dukshme në seancat në distancë. Në procedurat civile apo administrative, këto rreziqe janë më të ulëta pasi klienti mund të ketë gjithmonë komunikime paralele me avokatët me telefon ose mund të kërkojë pushim gjatë seancës. Ndonëse pushimi është zgjidhje për komunikimet private me avokatët, në Francë avokatët nuk e kërkojnë gjithmonë këtë, pasi kjo mund të pengojë ose të ngadalësojë shqyrtimin e çështjes nga gjykata. Në rastet kur për një person të ndaluar mund të organizohet një konsultim privat me avokatin në distancë, mund të dalin shqetësime rreth aksesit të këtij të fundit në një telefon të sigurt apo videolink të sigurt.

Në Francë nuk ka kuadër ligjor që rregullon vendndodhjen e avokatit gjatë seancave online (qoftë kur ai/ajo është në gjykatë bashkë me gjyqtarët apo në burg me klientin). Përveç kësaj, nuk rregullohen as situatat kur lind nevoja për komunikime private mes avokatit dhe klientit.

Në jurisprudencën e GjEDNj-së, ka pasur një çështje<sup>v</sup>, ku është konstatuar një shkelje për shkak se një gjykatë vendase nuk mund të argumentonte se pse avokati mbrojtës në apel ishte caktuar nga një rajon që ndodhej larg rajonit ku mbahej i ndaluar personi i akuzuar, gjë që kishte penguar komunikimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të qenësishëm. Ka gjithashtu çështje<sup>vi</sup> ku nga GjEDNj-ja është vlerësuar se ka pasur shkelje të nenit 6 në rastet kur klienti dhe avokati mund të komunikonin privatisht në të njëjtën sallë ku ndodheshin edhe prokurori dhe përmbauesi. Në një çështje tjetër<sup>vii</sup>, GjEDNj-ja u shpreh se një zgjidhje e mirë për komunikimet private mes avokatit dhe klientit mund të jenë linjat e sigurta të telefonit, kur klienti është i ndaluar.

#### 8. A MUND T'I HIQET ZËRI APO FIGURA NJË AVOKATI DHE/OSE NJË PALE GJATË NJË VIDEOKONFERENCE NGA GJYQTARI? CILAT JANË RREGULLAT PROCEDURALE?

Kërkesat për gjykim të drejtë dhe parimi i barazisë së armëve në procedimet gjyqësore kërkojnë që palët të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në procedime. Megjithatë, në disa raste një palë që ndërpret vazhdimisht seancën mund të përjashtohet përkohësisht nga seanca me vendim të gjyqtarit. E drejta e një pale të përjashtuar në këtë rast duhet të balancohet. Ndonëse Gjykata Evropiane ka një

jurisprudencë në lidhje me përjashtimin e palëve nga sallat e gjyqit<sup>viii</sup>, duket se për seancat *online* në shkallë kombëtare nuk ka ende raste të tilla. Në Angli, ka pasur diskutime rreth dëshmitarëve që ndërpresin seancat, rreth vështirësive në kontrollimin e tyre, si dhe diskutime për heqjen e zërit gjatë seancës si një zgjidhje afatshkurtër sa i përket drejtësisë së përgjithshme të procedimeve. Në Francë, ideja e heqjes së zërit një pale në seancë nuk do të pranohej nga komuniteti i profesionistëve të drejtësisë, për shkak se shihet si një rrezik ndaj kërkesës për burime të barabarta të mbrojtjes dhe akuzës.

#### 9. SI DUHET TË VEPROJË NJË GJYQTAR NË RASTIN E NJË LIDHJEJE JO TË MIRË TË INTERNETIT DHE PAMUNDËSISË SË NJË PALE PËR TË DËGJUAR/PËR TË FOLUR?

Zhvillimi i seancave në distancë kërkon që gjyqtarët të kenë aftësi të posaçme teknike dhe të bëjnë organizime logjistike para seancave, si dhe të marrin përsipër përgjegjësi të tjera menaxhimi. Për të siguruar lidhje cilësore gjatë seancave gjyqësore, do të ishte e rekomandueshme që të zhvillohen seanca prove para seancave në distancë. Për këto çështje procedurale dhe teknike duhet të hartohen udhëzime bazuar në rekomandimet e mëparshme të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për këtë fushë.

Rifillimi i seancave pas ndërprerjeve nuk është detyrë e lehtë për një gjyqtar, i cili duhet të sigurohet që të gjitha palët të kenë mundësi të barabarta për të paraqitur argumentet e tyre. Ndoshta një trajnim i posaçëm për gjyqtarët mund të ishte i dobishëm për këtë qëllim. Në rast ndërprerjesh teknike të vazhdueshme gjatë seancave, mund të shihet mundësia e shtyrjes së seancës. Megjithatë, në këtë rast duhet marrë parasysh kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimit.

#### 10. A KA RREGULLORE TË POSAÇME PROCEDURALE PËR SEANCAT NË DISTANCË DHE ÇFARË DUHET MARRË PARASYSH NË KËTO RASTE?

Çështjet në lidhje me seancat gjyqësore në distancë, si logjistika, vizibiliteti, ana etike dhe drejtësia e përgjithshme e procedurave duhet të merren që të gjitha parasysh në organizimin dhe zhvillimin e seancave *online*. Me vend do të ishin edhe udhëzime të posaçme të hartuara për palët për këtë qëllim<sup>ix</sup>. Çështja është se sa të nevojshme do të ishin rregullat e detyrueshme ligjore dhe a do të mjaftonte hartimi i disa udhëzimeve të natyrës nënligjore? Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë dhe të vazhdueshëm të teknologjisë, disa ekspertë janë pro rregullimit të butë (soft) përmes udhëzimeve dhe jo përmes rregullimeve të detyrueshme ligjorisht. Megjithatë, mënyra e rregullimit do të varet deri në njëfarë mase nga sistemi ligjor i vendeve përkatëse. Sidoqoftë, është e rëndësishme që të ketë udhëzime (në njërën apo në tjetrën formë). Përveç këtyre rregullimeve, rëndësi kanë edhe dy elementë të tjerë për gjykimin në distancë: (1) bashkëpunimi i palëve në procedimet *online* dhe (2) të bazuarit tek mësimet e nxjerra nga përvoja e mëparshme me gjykimet *online*.

Në Angli, seancat *online* janë të mirërregulluara. P.sh., aty ka udhëzime të posaçme për dëshmitarët dhe tani komuniteti ligjor po diskuton për nevojën e hartimit të udhëzimeve të ngjashme për avokatët.

Për të garantuar harmonizimin e legjislacionit ekzistues procedural me format e reja të zhvillimit të seancave përmes video-linqeve nevojitet rishikimi i tij. Probleme të caktuara mund të dalin nga përcaktimi strikt ligjor i çështjeve dhe i situatave, ku lejohen gjykimet *online*, duke mos lënë asnjë hapësirë për diskrecion gjyqësor, sidomos në rast situatash kritike, si p.sh. në rastin e krizës sanitare të COVID-19.

#### IV. Videokonferenca për vendimet e masave të sigurisë

##### 11. A MUND TË MERREN MASAT E SIGURISË PËRMES VIDEOKONFERENCAVE? CILAT JANË SPECIFIKAT E PROCEDURAVE NË KËTO RASTE?

Gjatë izolimit për shkak të Covid-19, në disa juridiksione u mundësua marrja e masave të sigurisë përmes seancave në distancë. Këto procedura kanë disa aspekte problematike: prezantimi i avokatit me personin e ndaluar dhe komunikimi privat mes tyre; mungesa e një kontakti të drejtpërdrejtë dhe privat mes avokatit dhe personit të ndaluar; disiplina gjatë seancave; rreziku i presioneve apo ndikimeve ndaj personit të ndaluar; angazhimi i palëve në seancë.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që të merren masa për garantimin e sigurive përkatëse dhe pjesëmarrjes efikase të personit të ndaluar në seancat online, sidomos në rastet kur avokati nuk ndodhet në të njëjtën sallë me personin përkatës.

Ndonëse GjEDNj-ja nuk ka ndonjë jurisprudencë sa u përket seancave në distancë sa i përket nenit 5 të Konventës, edhe për këto procedura aplikohen të njëjtat parime. Në këto raste, çështja e kohës dhe logjistikës mund të shtojë akoma më shumë kompleksitetin e procedurave, ndërkohë që besimi dhe komunikimi mes avokatit dhe klientit ka një rëndësi shumë të madhe. Sipas çështjeve Salduz<sup>x</sup> dhe Ibrahim<sup>xi</sup>, mosrespektimi i garancive procedurale të parashikuara në nenin 6 gjatë marrjes fillestare në pyetje mund të rrezikojë drejtësinë e procedurave të përgjithshme penale në raste të caktuara, gjë që tregon rëndësinë si në këtë fazë të procedurave, ashtu edhe rëndësinë e besimit mes avokatit dhe klientit të tij.

##### Jurisprudenca përkatëse e GjEDNj-së:

- [BIVOLARU kundër RUMANISË \(Nr. 2\) nr. 66580/12, 2 tetor 2018](#)
- [BLOKHIN kundër RUSISË \(GC\) nr. 47152/06, 23 mars 2016](#)
- [DOYLE kundër IRLANDËS nr. 51979/17, 23 maj 2019](#)
- [GRYAZNOV kundër RUSISË nr. 19673/03, 12 qershor 2012](#)
- [IDALOV kundër RUSISË \(Nr. 2\) nr. 41858/08, 13 dhjetor 2016](#)
- [KASPAROV e të TJERË kundër RUSISË \(Nr. 2\) nr. 51988/07, 13 dhjetor 2016](#)
- [KHODORKOVSKIY DHE LEBEDEV kundër RUSISË nr. 11082/06, 13772/05, 25 korrik 2013](#)
- [MAKEYEV kundër RUSISË nr. 13769/04, 5 shkurt 2009](#)
- [NEKRASOV kundër RUSISË nr. 8049/07, 17 maj 2016](#)
- [RAZVOZZHAYEV kundër RUSISË DHE UKRAINËS DHE UDALTSOV kundër RUSISË, nr. 75734/12, 2695/15, 55325/15, 19 nëntor 2019](#)
- [ROKHLINA kundër RUSISË nr. 54071/00, 7 prill 2005](#)
- [SAKHNOVSKIY kundër RUSISË nr. 21272/03, 2 nëntor 2010](#)
- [SCHATSCHASCHWILI kundër GJERMANISË nr. 9154/10, 15 dhjetor 2015](#)
- [T.P. AND K.M. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR nr. 28945/95, 10 maj 2001](#)
- [TREPASHKIN kundër RUSISË \(NR. 2\) nr. 36898/03, 19 korrik 2007](#)
- [MARCELLO VIOLA kundër ITALISË, nr. 45106/04, 5 tetor 2006](#)
- [GOLUBEV kundër RUSISË \(dec.\), nr. 26260/02, 9 nëntor 2006](#)

- GRIGOREVSKIKH kundër RUSISË, nr. 22/03, 9 prill 2009
- SAKHNOVSKY kundër RUSISË [GC], nr. 21272/03, 2 nëntor 2010
- KHISMATULLIN kundër RUSISË, nr. 33469/06, 11 dhjetor 2014
- BIVOLARU kundër RUMANISË (N° 2), nr. 66580/12, 2 tetor 2018

## FOLËSIT

Z. **Vasily Lukashevich**, Avokate me përvojë, Regjistri i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Znj. **Maria Filatova**, PhD, Profesore e Asociuar në Fakultetin Juridik të Shkollës së Lartë të Ekonomikut (Rusi), ku ajo është Shefe e Laboratorit të Drejtësisë Ndërkombëtare. Znj. Filatova ka punuar me Këshillin e Evropës për shumë çështje që lidhen me KEDNJ-në dhe veçanërisht sa u përket garancive procedurale në procedimet gjyqësore.

Z. **Jeremy McBride**, Avokat, Dhoma e Avokatisë e Monckton (Mbretëria e Bashkuar). Z. McBride është avokat që ushtron detyrën e avokatit të të drejtave të njeriut që përfaqëson klientët para Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe para organeve të traktateve të OKB-së ka qenë anëtar i Komitetit Shkencor të EU FRA. Ai ka dhënë shumë opinione si ekspert për çështje të KiE-s që lidhen me KEDNJ dhe me procedurën penale. Është autor i një libri mbi këtë temë, i botuar në dy numra dhe i përkthyer në shumë gjuhë evropiane.

Znj. **Ivana Krstic**, PhD, Profesore e Asociuar, Fakulteti Juridik, Universiteti i Beogradit (Serbi). Znj. Krstic është eksperte në të drejtën penale ndërkombëtare dhe në të drejtën evropiane të të drejtave të njeriut dhe drejton klinikën ligjore të të drejtave të njeriut në Universitetin e Beogradit.

Z. **Christian Licoppe**, profesor i Sociologjisë së Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, Shkolla Kombëtare e Telekomunikimit Paris-Tech (Francë). Z. Christian Licoppe është trajnuar fillimisht si inxhinier (Ecole Polytechnique) dhe kërkues shkencor në fizikën e lëndës së kondensuar dhe më pas i është kushtuar historisë së shkencës dhe sociologjisë së dixhitalizimit. Ka kryer studime të shumta shkencore dhe ka bërë një sërë publikimesh për përdorimin e videokonferencave në seancat gjyqësore. Ka bashkëpunuar si ekspert shkencor me Komisionin Evropian për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ).

<sup>i</sup> MURTAZALIYEVA kundër RUSISË, nr. 36658/05, 18 dhjetor 2018

<sup>ii</sup> [SAKHNOVSKY kundër RUSISË \[GC\], nr. 21272/03, 2 nëntor 2010](#)

<sup>iii</sup> RIEPAN kundër AUSTRIË, nr. 35115/97, 14 Nëntor 2000

<sup>iv</sup> S. kundër ZVICRËS, nr. 12629/87 DHE 13965/88, 28 Nëntor 1991

<sup>v</sup> [SAKHNOVSKY kundër RUSISË \[GC\], nr. 21272/03, 2 Nëntor 2010](#)

<sup>vi</sup> ICHETOVKINA E TË TJERË kundër RUSISË, nr. 12584/05 dhe 5 të tjerë, 4 korrik 2017

<sup>vii</sup> [MARCELLO VIOLA kundër ITALISË, nr. 45106/04, 5 tetor 2006](#)

<sup>viii</sup> IDALOV kundër RUSISË, nr. 5826/03, 22 maj 2012

<sup>ix</sup> Shih Deklaratën e CEPEJ për "[Mësimet e nxjerra dhe sfidat e ndeshura nga gjyqësori gjatë dhe pas pandemisë së COVID-19](#)".

<sup>x</sup> SALDUZ kundër TURQISË, nr. 36391/02, 27 nëntor 2008

<sup>xi</sup> IBRAHIM E TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR, nr. 50541/08 et al., 13 shtator 2016

*Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të asnjërës palë.*

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe